



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 124 prot.

Kamëz, më 18.10.2021

V E N D I M

Nr. 93 Datë 18 / 10 2021
PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 18.10.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt –Vendim Nr.89 Datë 14.10.2021 mbështetur në Ligjin 57, datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”; Kreun IV, pika 2, të Vendimit nr.955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar; Udhëzimit nr.5, date 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri ne 6%”, të ndryshuar; Kreun IV, pika 3, të VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit SHTATOR 2021, prej 49 familjeve me një fond prej 165.428 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind e njëzet e tetë) lekë që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë, për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet e bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti

